



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 665 / Prot.
5

Tiranë më 22.07.2020

REKOMANDIM

Nr. 17, datë 22.07.2020

PËR KONTROLLUESIN “*DRITAN KAPAJ - PERSON FIZIK (BAR ZIG ZAG)*”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim “*Ligji*”), ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “*Dritan Kapaj-Person Fizik (Bar Zig Zag)*”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 111, datë 26.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “*Dritan Kapaj-Person Fizik (Bar Zig Zag)*” (në vijim, “*Kontrolluesi*”), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.

Hetimi administrativ, pranë kontrolluesit, u fokusua në:

- (i) trajtimin e ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, i cili pretendonte se Kontrolluesi i ka pozicionuar kamerat e vendosura për sigurinë e ambientit ku ushtron aktivitetin, në hyrje të pallatit duke cenuar privatësinë e banorëve, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit; dhe
- (ii) verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtarinë si bar-kafë. Me qëllim garantimin e sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, Kontrolluesi ka instaluar një sistem video survejimi (CCTV), të përbërë nga 2 kamera. Nga verifikimet e bëra dhe provat e administruara, rezulton se kamerat janë të pozicionuara vetëm në ambientet e brendshme të Kontrolluesit.
2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, u konstatua se objekti i ankesës nuk është i bazuar në prova dhe nuk lidhet me situatën faktike të përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit nga ana e Kontrolluesit.
3. Kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit dhe standardit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit mbi *“Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre njohjen me të drejtat që iu janë akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi nuk e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

5. Kontrolluesi nuk disponon një *“Rregullore për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejit”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi përdorimin e këtij sistemi, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e aksesit, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i kësaj rregulloreje, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Gjithashtu, do të shërbente në sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e personave që kanë akses në këto të dhëna, mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe detyrimet ligjore.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit, në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka pranuar shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/1"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për të vendosur tabelat informuese sipas standardit të miratuar në Udhëzimin nr. 3, të Komisionerit, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, për prezencën e sistemit të video survejimit.
2. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22, të Ligjit.
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27, të Ligjit, të hartojë "*Rregulloren për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejimit*", në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi përdorimin e këtij sistemi, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e aksesit, etj.
4. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimin e parashikuar në pikën 1 më sipër; dhe
 - (ii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 3.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

6. Në rast mospërbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit.

Rrjedhimisht, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet përkatëse administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22.07.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

